



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2022:152841

Datë: 29.07.2024

Numri i dokumentit: 05991752

P.nr.207/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK, Departamenti I Pergjithshem-Divizioni Penal, Gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Indira Beqa, në çeshtjen penale ndaj të pandehurit B.M nga Ferizaj, i akuzuar për veprën penale, Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.1017/22 të datës 26.07.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me dt.10.07.2024, në prezencë të prokurorit të shtetit Ardian Emini, përfaqësuesit të dëmtuarës Enver Thaqi dhe të pandehurit, me dt.16.07.2024 mori dhe shpalli, ndërsa me dt. 26.07.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri B.M nga Ferizaj, i lindur më dt...., nga i ati N... dhe e ëma H..., e gjinisë S..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, prind I një fëmije, ka të kryer shkollën e mesme, merret me punë të bujqësisë, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr.personal:

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 07.07.2022 rreth orës 9:15 min në vendin e quajtur "Ara e Cenës", rajoni ekonomiko-pyJOR Hani i Elezit ,në pyllin publik më qëllim të vjedhjes e në kundërshtim me dispozitat e Ligjit mbi Pyjet e Kosovës 2003/03, fillimisht i kishte pret tridhjeteshtatë (37) copë druje të njomë llojit ahu dhe shkozë , diametër 12-19 cm, lartësi 10 m, vëllim i përgjithshëm 2,96 m³,të cilat pastaj i ka përgatitur për t'i bart me kuaj me samar deri në rrugën kryesore e që pastaj të njëjtat ti bart me traktor, për shkak terrenit të papërshtatshëm ,duke i shkaktuar kështu të dëmtuarës Autoritetit PyJOR Komunal –Hani i Elezit, dëme material në vlere prej 452,85€,

Me këtë veprim, i pandehuri këtë ka kryer veprën penale Vjedhja pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në baze të nenit 2,7,38,48, 69,70 te KPRK-se, nenit dhe nenit 358,359,360 dhe 364 të KPP-së, e

G J Y K O N

Me dënim me kusht, me të cilin i vërtetohet dënimi me gjobë në shumë prej 500.00€ (pesëqind euro), i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej një viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk do të kryejë vepër tjetër penale, në të kundërtën do t'i revokohet dënimi me kusht.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë pranë kësaj gjykate shumë prej 30,00 € , ndërsa në emër të taksës për Fondin e Kompensimit të Viktimave te Krimin ne shume prej 20.00€, te gjitha keto paguhen pasi qe ky aktgjykim te merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

E dëmtuara APK-Hani Elezit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.1017/22 të datës 26.07.2022, të pandehurin B.M nga Ferizaj, e ka akuzuar për veprën penale, Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së.

Ne bazë të kësaj aktakuze gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me dt.11.05.2023, me të cilin rast i pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Ne shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt.10.07.2024, prokurori i shtetit nga Prokuroria Themelore në Ferizaj, Ardian Emini, mbeti në tërësi pranë aktit akuzues të paraqitur me shkrim pranë kësaj gjykate pa ndryshime dhe plotesime. Në fjalën përfundimtare ka theksuar se, pas administrimit të provave personale dhe materiale gjatë shqyrtimit gjyqësor, u vërtetua se I pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, prandaj edhe I ka propozuar gjykatës që i pandehuri, të shpallet fajtor dhe t'i shqiptohet sanksion penal sipas ligjit, duke patur parasysh si rrethanë rënduese faktin se I njejtë është recidivist, pa propozuar edhe ndonjë rrethanë lehtësuese.

Përfaqësuesi I të dëmtuarës në fjalën e tij, I bashkangjitet ndjekjes penale dhe parashtrohet kërkesë pasurore juridike në vlerën si në aktakuzë, dhe njëherit mbështet në tërësi fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit.

I pandehuri B.M, në fjalën e tij në shqyrtimin gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale që i vëhet në barrë sipas aktit akuzues. Në mbrojtjen e deklaron se nuk i kujtohet që ditën kritike të jetë takuar nga roja e pyllit Q.K, derisa pranon se ka patur herë të tjera kur është takuar nga kjo roje pylli. Në fjalën e tij përfundimtare thekson se nuk e ndien veten fajtor për këtë veprë penale, prandaj kërkon nga gjykata që t'a lirojë nga akuza për rastin konkret .

Gjykata ne shqyrtimin gjyqësor prezantoi provat e propozuara me dëgjimin e dëshmitarit Q.K, leximin e fletparaqitjes dhe procesverbalit për vlerësimin e dëmit me nr.103/22 të dt.18.07.2022, deklarata e e dëshmitarit Q.K e dhënë në Prokurori me dt.21.07.2022.

Pas prezantimit të provave dhe vlerësimit të tyre te plotë, secilën veç e veç dhe të gjitha në tërësi, mbrojtjes se të pandehurit si dhe bindjes së lirë te gjykatës, gjykata vërtetoi gjendjen faktike si ne dispozitiv.

Nga deklarata e dëshmitarit Q.K gjykata vërtetoi se me dt. 07.07.2022, duke qenë në detyrë zyrtare si roje pylli në APK- Hani Elezit, në vendin e quajtur “Ara e Cenës” e kishte takuar të pandehurin B.M, i cili kishte prerë në pyllin pronë publike 37 copë drunj, të cilët fillimisht i kishte bartur me kuaj me samar deri në rrugë kryesore, ku aty e kishte edhe traktorin për transport të mëtutjeshëm. Po nga kjo dëshmi gjykata vërtetoi se drunj të ishin prerë nga i pandehuri, pa patur ndonjë leje përkatëse

Fakte të njejta janë vërtetuar edhe nga leximi i fletëparaqitjes dhe procesverbali i vlerësimit të dëmit me nr.103/22 të dt.18.07.2023, dhe deklarata e dëshmitarit Q.K e dhënë në Prokurori me dt.21.07.2022.

Gjykata u fali besimin këtyre dëshmime, meqë të njëjtat gjejnë mbështetje në njëra tjetrën dhe në provat materiale të administruara dhe sepse me të njëjtat në mënyrë të qartë dhe bindëse është përshkruar koha, vendi dhe mënyra e kryerjes së veprës penale.

Gjykata vlerësoi posaçërisht edhe mbrojtjen e të pandehurit, se të njëjtit nuk i kujtohet që ditën kritike kishte qenë në pyll për të prerë drunj, ndërsa pranon se ka patur here të tjera kur është takuar nga dëshmitari Q.K, mirëpo mbrojtjes së të pandehurit, si të tillë gjykata nuk mund t'i fal besimin, pasi që Gjykata vlerësoi se i pandehuri, përmes kësaj mbrojtje vetëm ka tentuar që t'i shmanget përgjegjesisë penale për rastin në fjalë.

Me rastin e matjes dhe caktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 70 të KPRK-së, kështu që rrethanë lehtësuese gjykata nuk gjeti , ndërsa rrethanë të posaçme rënduese gjykata gjeti faktin se i njëjti, bazuar në evidencën e gjykatës, ka patur edhe raste tjera kundërvajtëse dhe penale, të natyrës së njejtë .

Andaj gjykata, për këto arsye, të pandehurin B.M, i akuzuar për veprën penale, , Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së, e gjykoi me dënim si ne dispozitiv, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është në proporcion me veprën si dhe sjelljen e të pandehurit, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, personalitetin e të pandehurit, andaj edhe konsideron se ky dënim do të ndikojë pozitivisht tek i pandehuri dhe personat tjerë që të mos kryejnë vepra të tilla penale dhe se me këtë do të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nenpar.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për kërkesën pasurore juridike, është i bazuar në dispozitën e nenit 462 par.2 të KPP-së.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

P.nr.207/22 datë 26.07.2024

Sekretarja juridike,

Indira Beqa

Gjyqtarja,

Zajrete Muhaxheri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.